

I.C.
ANKARA 10. NOTERLİĞİ
İzmir Cad. İhtamur Sok. No. 9/9
Tel: 417 12 50 - Fax: 417 12 52

Nö 09695

PUBLIKIM I ZYRËS SË REGJISTRIT TREGTAR TË AYDIN-it

10 HAZİRAN 2021

Numri i Regjistrir
Tregtar : 4294

Emërtimi Tregtar i
Kompanisë : GÖÇAY İNŞAAT, TAAHHÜT VE TİCARET ANONİM ŞİRKETİ

Adresa e selisë : Aydın İli, Cuma Mahallesi, Gazi Bulvarı, Nr.12.

Në datën 13/03/1979 shpallet regjistrimi në zyrën tonë tregtare i Statutit të shoqërisë tregtare me seli, numër regjistrimi dhe emërtim tregtar të shkruar sa më sipër në përshtatje me dispozitat e Kodit Tregtar Turk për Statutin e Shoqërisë Anonime në fjalë, themelimi i të cilës është lejuar me miratimin e datës 02/03/1979 mbështetur në nenin 273 të Kodit Tregtar Turk, pasi nga Ministria e Tregtisë është aprovuar; Statuti i shoqërisë me 33 nene gjithsej, i shpallur me vendimin Nr.979/73 D.İş. të Gjykatës Civile të Shkallës së Parë të Aydın-it për çështjen me numër regjistrimi themeltar Esas 979/71 D.İş., me qëllim ushtrimin e aktivitetit të shkruar në nenin 3 të Statutit; deklaratat për korrigjimin e neneve 3, 14, 16, 17, 21,25 dhe 27 të Statutit.

GJYKATA CIVILE E SHKALLËS SË PARË
AYDIN

Nr.Regj.Themeltar : 979/71 D.İş.
Nr.Vendimit : 979/73 D.İş.

Në Cilësinë e Gjykatës Tregtare të Shkallës së Parë të Aydın-it:

VENDIM

Trupi gjykues:

Gjykatësi : I. Remzi Köse (13797)

Sekretare gjyqësore : Hatice Baysal

Paditësit : Ortakët e shoqërisë anonime "GÖÇAY İnşaat Taahhüt

ve Ticaret Anonim Şirketi":

1. Mehmet Nuri Göçen (Adresa: Gazi Bulvarı, No:12, Aydın)
2. Mustafa Göçen (Adresa: Büyük Menderes Bulvarı, No:20/8, Aydın)
3. Hamdi Göçen (Adresa: Zafer Mahallesi, 42 Sokak, No:5, Aydın)
4. Naile Göçen (Adresa: Zafer Mahallesi, 42 Sokak, No:5, Aydın)
5. İbrahim Ethem Özbay (Adresa: Zafer Mahallesi, 42 Sokak, No:5, Aydın)

Objekti i padisë: Kërkesë për vërtetimin e themelimit të shoqërisë tregtare "GÖÇAY İnşaat Taahhüt ve Ticaret Anonim Şirketi"

Gjykata me përbërjen e mësipërme pasi shqyrtoi kërkesëpadinë e datës 08/03/1979, që në Gjykatën tonë është depozituar nga Bordi i Drejtorëve (Këshilli Drejtues) në emër të shoqërisë paditëse me objekt miratimin e krijimit të shoqërisë tregtare me emrin "GÖÇAY İnşaat Taahhüt ve Ticaret Anonim Şirketi" dhe administroi provat shkresore bashkangjitur kërkesës,

VËREN

Se Statuti i shoqërisë "GÖÇAY İnşaat Taahhüt ve Ticaret Anonim Şirketi" e cila do të themelohet me një kapital fillestar 600.000 Lira, është aprovuar Ministria e Tregtisë me shkresën nr.10471, datë 02/03/1979 dhe kështu janë plotësuar dispozitat e Kodit Tregtar.

Shuma prej 150.000 Lira, që korrespondon me 25% të kapitalit të shoqërisë tregtare "GÖÇAY İnşaat Taahhüt ve Ticaret Anonim Şirketi", që kërkohet të themelohet sipas dispozitave të Kodit Tregtar Turk për themelimin e menjëhershëm të biznesit, me një kapital prej 600.000 Lira dhe me seli tregtare në rrethin Aydın, është depozituar më datë 02/01/1979 në degën e Aydın-it të bankës "Pamukbank Türk Anonim Şirketi".

Sipas shkresës nr.10471 dhe datë 02/03/1979 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tregtisë së Brendshme, Ministria e Tregtisë është lejuar themelimi i Shoqërisë Anonime në fjalë në përputhje me nenin 273 dhe vijues të Kodit Tregtar Turk.

Është shlyer 25% e kapitalit themeltar dhe janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme.

PËR KËTO ARËSYE

Gjykata në përfundim të gjykimit të zhvilluar dhe pas administrimit të dosjes,

VENDOSI

Pranimin e kërkesës dhe miratimin e krijimit të shoqërisë tregtare "GÖÇAY İnşaat Taahhüt ve Ticaret Anonim Şirketi",

Arkëtimi i tarifës për vërtetimin e themelimit të Shoqërisë në shumën 100 Lira duke i marrë nga paditësit.

Vendimi u mor dhe u shpall në datën 08/03/1979.

Gjyqtari (13797) (nënshkrimi)
Sekretarja gjyqësore (nënshkrimi)

VËRTETIMI I NËNSHKRIMEVE

Sipas Vendimit Nr.1 marrë më datë 08/03/1979 dhe që është i shkruar në faqen e parë teke (1) të Librit të Vendimeve të shoqërisë tregtare "GÖÇAY İnşaat Taahhüt ve Ticaret Anonim Şirketi", vërtetuar nga Noteria Nr.2 e qytetit Aydın me aktin noterial numër 5512, datë 22/02/1979, personat me emrat Mustafa Göçen dhe Mehmet Nuri Göçen janë autorizuar për të përfaqësuar individualisht ose bashkërisht me nënshkrimet e tyre shoqërinë me emërtim tregtar si më lartë, konkretisht duke e përfaqësuar shoqërinë para të gjitha institucioneve zyrtare, personave fizikë dhe juridikë, bankave; të marrin angazhime në emër të shoqërisë; të marrin pjesë në tenderë, të nënshkruajnë kërkesat e pjesëmarrjes, të paraqesin oferta, të depozitojnë sigurimin e ofertës dhe të kontratës, si dhe t'i tërheqin ato, të firmosin kontratën, të përpilojnë dhe firmosin kërkesat për pagesat progresive, të mbledhin dhe arkëtojnë pagesat progresive, të blejnë dhe

sin, të marrin dhe japin me qira në emër të shoqërisë çdo lloj pasurie të
undshme dhe të patundshme; të përpilojnë dhe nënshkruajnë çdo lloj shkresë,
dokumenti të nevojshëm për të kryer të gjitha tagrat e shkruara këtu.

Deklarojmë se nënshkrimet tona gjatë përfaqësimit të shoqërisë do të jenë
si në shembullin e paraqitur më poshtë.

Mustafa Göçen
Zv.Kryetar i Bordit Drejtues
//nënshkrimi//

Mehmet Nuri Göçen
Kryetar i Bordit Drejtues
//nënshkrimi//

10 HAZIRAN 2021

Vërtetuar nga
Süleyman Cincioğlu
Noteri i 2-të në Aydın
(Vula Zyrtare dhe
Nënshkrimi)

(Faqe 95)

STATUTI
i shoqërisë aksionere me emërtimin tregtar
"GOÇAY, TAAHHUT VE TICARET ANONIM SİRKETİ"

Themelimi dhe themeluesit:**Neni-1**

Mes themeluesve, emri, mbiemri, shtetësia dhe adresat e të cilëve janë shkruar
më poshtë, është krijuar një Shoqëri Anonime në përputhje me dispozitat e Kodit
Tregtar Turk me qëllim kryerjen e veprimtarisë sipas dispozitave të këtij statuti.

Emri -Mbiemri i Themeluesit	Adresa zyrtare	Shtetësia
1. Mehmet Nuri Göçen	Gazi Bulvarı No.12, Aydın	Turke
2. Mustafa Göçen	Büyük Menderes Bulvarı No.20/8, Aydın	Turke
3. Hamdi Göçen	Zafer Mahallesi 42.Sokak No5, Aydın	Turke
4. Naile Göçen	Zafer Mahallesi 42.Sokak No5, Aydın	Turke
5. İbrahim Ethem Özbay	Zafer Mahallesi 42.Sokak No5, Aydın	Turke

Emërtimi tregtar i shoqërisë**Neni-2**

Emërtimi i shoqërisë është: "GÖÇAY İnşaat, Taahhüt ve Ticaret Anonim Şirketi".

Qëllimi i operimit dhe objekti i aktivitetit të shoqërisë**Neni-3**

Qëllimi i krijimit, operimit dhe objekti kryesor i shoqërisë është si më poshtë:

1) Shoqëria ndërton çdo lloj banesë, kompleksi dhe fabrike, dyqane, magazina, depo,
rrugë, diga, dekupazh, ujëmbajtës, ujësjellës, kanalizime, impiante ujitjeje, drenazhim,

porte dhe aeroporte, transport të llojeve të ndryshme dhe çdo lloj angazhim sipërmarrje; shitja dhe dhënia me qira e tregtimi i ndërtimeve të bëra, shërbime (Punime ndërtimi civile dhe industriale), projektim, komision, përfaqësim, të gjitha e importit dhe eksportit, transport dhe punë kontraktimi të të gjitha llojeve brenda jashtë vendit.

2) Merr pjesë në tenderët e nxjerrë nga institucionet zyrtare, personat fizikë dhe juridikë për punët që janë pjesë e objektit të aktivitetit të Shoqërisë, ose për punët/projektet që këto duan të realizojnë, ul dhe rrit ofertën e dorëzuar, japë/bëjë ofertë, bëjë/lidhë kontratat.

3) Shoqëria merr në dorëzim me transferim nga persona të tjerë fizikë ose juridikë punë që janë pjesë e objektit të aktivitetit të saj ose ia transferon dikujt tjetër këto punë. Gjithashtu Shoqëria kryen punët e Komisionit Ndërmjetësues si dhe merr përsipër me tender dhe kontraktim punët e institucioneve të huaja zyrtare ose private.

4) Shoqëria krijon partneritet/ortakëri me personat fizikë dhe juridikë në lidhje me objektin e aktivitetit të saj, merr pjesë në ortakëritë e themeluara më parë. Për këtë qëllim Shoqëria blen certifikata aksionesh ose i transferojë këto tek të tjerët; shpërndan ortakëritë ose e likuidon atë.

5) Për të realizuar qëllimin dhe objektin e saj Shoqëria bën investimet e nevojshme, ndërton e hap fabrika dhe komplekse; nëse është e nevojshme blen, importon, merr me qira makineri, pajisje dhe mjete motorike ose jo-motorike; blen pasuri të patundshme; në rast nevojë vendos kufizime, hipotekon në favor të personave të tretë patundshmëritë që janë në pronësi të saj, ose e heq hipotekimin duke e çliruar nga barrët; të vendosë të drejtat në natyrë në favor dhe disfavor të Shoqërisë; të kalojë në emrin e vet certifikatat/licensat e personave të tjerë fizikë dhe juridikë për punime kontraktuese.

6) Shoqëria blen ose shet të drejta koncesionare, të drejta të autorit, pronësisë intelektuale, të drejta industriale si know-how që janë të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të saj. Gjithashtu Shoqëria regjistron markat e veta ose transferon në emrin e vet marka të të tretëve.

7) Përveç punëve/aktiviteteve të përmendura më lartë, në rast se në të ardhmen do të kërkohet angazhim për punë të tjera të vlefshme dhe të nevojshme për Shoqërinë, atëherë Shoqëria do të mund t'i kryejë edhe këto punë vetëm pas propozimit të Bordit Drejtues dhe miratimit nga Asambleja e Përgjithshme (e aksionarëve) dhe marrjes së vendimit në këtë drejtim.

Për zbatimin e këtij vendimi në cilësinë e ndryshimit të Statutit të Shoqërisë do të merren lejet e nevojshme nga Ministria e Industrisë dhe Tregtisë.

Kohëzgjatja:

Neni-4

Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë 20 (njëzetë) vjet duke filluar nga data e regjistrimit dhe shpalljes së themelimit të saj. Por kjo kohëzgjatje mund të shkurtohet e zgjatet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve dhe duke marrë lejen e nevojshme nga Ministria e Tregtisë.

Selia, filialet dhe degët e shoqërisë:

Neni-5

Selia e Shoqërisë është në adresën: Cuma Mahallesi, Gazi Bulvarı No:2, Aydin. Por Shoqëria mund të krijojë, hapë, themelojë filiale, degë, agjenci dhe përfaqësi të saj brenda dhe jashtë vendit me vendim të Këshillit Drejtues në përshtatje me Kodin Tregtar turk dhe dispozitat e legjislacionit përkatës duke njoftuar për këtë veprim edhe Ministrinë e Tregtisë.



Kapitali dhe aksionet**Neni-6**

Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është 600.000.-TL (gjashtëqind mijë Lira Turke).

Kapitali është i ndarë në gjithsej 100 (njëqind) aksione, të gjitha me vlerë nominale 6.000-TL (gjashtëmijë Lira Turke) dhe të emëruara.

Forma e pjesëtimit dhe struktura e kapitalit të Shoqërisë është si më poshtë:

10 HAZIRAN 2021

Ortaku	Numri i Aksioneve	Vlera në Lira
1- Mehmet Nuri Göçen	39	234.000
2- Mustafa Göçen	30	180.000
3- Hamdi Göçen	20	120.000
4- Naile Göçen	10	60.000
5- İbrahim Ethem Özbay	1	6.000
SHUMA TOTALE =		600.000

Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar i gjithi nga aksionarët dhe ¼ e vlerës së aksioneve është likuiduar (shlyer).

Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë**Neni-7**

Pasi të jenë paguar plotësisht shumat e certifikatave të aksioneve që korrespondojnë me kapitalin themeltar të Shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme (e aksionarëve) mund të zmadhojë kapitalin e saj me një vendim që do të marrë në përputhje me nenin 391 dhe vijues të Kodit Tregtar Turk.

Emetimi i të sigurtave**Neni-8**

Që vendimi i Asamblesë së Përgjithshme (të aksionerëve) për të emetuar letra me vlerë, të sigurta etj. të jetë i vlefshëm është esenciale që përveç marrjes së lejes nga Ministria e Tregtisë, vendimi duhet të regjistrohet në Regjistrin Tregtar dhe shpallet duke u publikuar Fletoren Zyrtare të Regjistrit. Shoqëria mund të emetojë të sigurta në raport me kapitalin e saj të shlyer dhe sipas dispozitave të Kodit Tregtar Turk.

Këshilli Drejtues (Bordi i Drejtorëve)**Neni-9**

Përfaqësimi dhe administrimi i Shoqërisë bëhet nga një Këshill Drejtues me tre (3) anëtar, që do të zgjidhen mes aksionerëve nga Asambleja e Përgjithshme (e Aksionerëve).

Si anëtarë të parë të Këshillit Drejtues me detyrë deri në mbledhjen e parë të Asamblesë së Zakonshme të Përgjithshme (të aksionerëve) janë zgjedhur:

- 1) Mehmet Nuri Göçen,
- 2) Mustafa Göçen,
- 3) Hamdi Göçen

Mandati i këshillit drejtues**Neni-10**

Këshilli Drejtues qëndron në detyrë për tre (3) vjet. Anëtarët kanë të drejtë rizgjedhjeje. Në qoftë se ndonjë prej anëtarëve të Këshillit Drejtues nuk merr pjesë në



tre (3) mbledhje të njëpasnjëshme të Këshillit pa një justifikim të vlefshëm, shkarkohet nga detyra me vendim të shumicës së Këshillit Drejtues.

Në mungesë të Kryetarit të Këshillit Drejtues, zgjidhet përkohësisht një nga anëtarët e tjerë të Këshillit. Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit Drejtues së bashku me Kryetarit të Këshillit Drejtues bëhet nga pjesëmarrësit në mbledhjen e parë mbahet pas mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme (të aksionerëve) të Shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme (e aksionerëve) mund të marrë vendim në çdo kohë për ndryshimin e përbërjes së Këshillit Drejtues.

Dorëzimi i certifikatave të aksioneve

Neni-11

Anëtarët e Këshillit Drejtues janë të detyruar që certifikatat e aksioneve t'i dorëzojnë si garanci (siguracion) referuar dispozitave të nenit 313 të Kodit Tregtar Turk.

Detyrat e anëtarëve të Këshillit Drejtues

Neni-12

Është në kompetencën e Këshillit Drejtues të marrë të gjitha vendimet për çështjet e përcaktuara në Kodin Tregtar Turk dhe në këtë Statut përveç çështjeve që kërkojnë patjetër vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.

Administrimi dhe përfaqësimi i kompanisë mund të shpërndalet midis anëtarëve të Bordit Drejtues. Natyra dhe fushëveprimi e kësaj shpërndarje vendoset nga Bordi Drejtues. Të gjitha ose disa prej punëve të përfaqësimit dhe administrimit mund t'u lihen nga Bordi Drejtues përfaqësuesve ekzekutivë.

Nëse Bordi Drejtues e gjykon të nevojshme, ai mund të autorizojë Drejtorët dhe përfaqësuesit tregtarë, të cilët nuk janë domosdoshmërisht aksionarë, të nënshkruajnë dhe përfaqësojnë në emër të Kompanisë. Afati i shërbimit të atyre që marrin titullin Drejtor dhe përfaqësues nuk është i kufizuar në mandatin e Bordit Drejtues.

Me vendim të Bordit Drejtues mund të bëhen veprimet e mëposhtme:

- Përcaktimi i kohës dhe kushteve të atyre që do të veprojnë në fushat e veprimtarisë të përfshira në qëllimin dhe objektin e kompanisë.
- Blerja, shitja dhe marrja me qira e pasurive të patundshme në emër të kompanisë, dhënia për Hipotekë e pasurive të patundshme të kompanisë.
- Përcaktimi i kushteve dhe shumave të marrëdhënieve financiare që do të lidhen me bankat dhe institucionet e tjera të kredisë vendase dhe të huaja, dhënia e pasurive të luajtshme dhe pasurive të paluajtshme si kolateral.
- Hapja e degëve, agjencive, ndërtimi i objekteve, mbyllja ose shpërbërja e tyre.
- Përgatitja e programit vjetor të veprimtarisë, e buxhetit dhe stafit vjetor si dhe ndryshimi i tyre në rast nevojë
- Përgatitja e raportit të aktivitetit duke përfshirë llogarinë e bilancit e fitimit dhe të humbjes dhe paraqitjen e tij në Asamblesë së Përgjithshme.

(Faqe 96)

Përfaqësimi dhe administrimi i Shoqërisë

Neni-13

Administrimi i Shoqërisë dhe përfaqësimi i saj tek personat e tretë është detyrë që i takon Këshillit Drejtues. Që shkresat dhe dokumentacioni që Shoqëria do t'u japë personave të tretë, apo çdo lloj kontrate e marrëveshje që do të lidhë Shoqëria me të

et, të jenë të vlefshme duhet që poshtë titullit zyrtar të shoqërisë ato të firmosen të paktën nga një person i autorizuar me të drejtë përfaqësimi.

Mbledhja e Bordit Drejtues Neni-14

10 HAZIRAN 2021

Bordi Drejtues mbledhet sa herë është e nevojshme nga biznesi dhe transaksionet e kompanisë. Sidoqoftë, me kusht që të rezervohen dispozitat e paragrafit 2 të nenit 330 të Kodit Tregtar Turk, ai mbledhet të paktën një herë në tre muaj në një kohë dhe vend për t'u përcaktuar vetë Bordi. Nëse nuk përcaktohet vendndodhja, vendi i takimit është selia e kompanisë.

Rendi i ditës i mbledhjes së zakonshme të Bordit Drejtues u njoftohet anëtarëve me letër rekomande të paktën 7 (shtatë) ditë para datës së mbledhjes nga Kryesia e Bordit Drejtues.

Pagat e Anëtarëve të Bordit Drejtues Neni-15

Anëtarët e Bordit Drejtues mund të marrin një tarifë që përcaktohet dhe vendoset nga Asambleja e Përgjithshme për çdo ditë mbledhjeje, përveç dividendëve që do të lihen mënjanë dhe do të paguhen në përputhje me nenin 27 të kësaj marrëveshjeje.

Auditorët Neni-16

Auditorët zgjidhen për një mandat (dy) 2-vjeçar nga Asambleja e Përgjithshme mes aksionarëve të Shoqërisë ose jashtë saj.

Si auditor i parë, për një periudhë njëvjeçare është zgjedhur jashtë aksionareve të shoqërisë Atif Aysever.

Auditori i Menaxhimit, i cili ka lënë detyrat e tij ose mandati ligjor i të cilit ka përfunduar, mund të rikthehet në këtë detyrë.

Kushdo që ka përfunduar mandatin e tij ose nuk është shkarkuar

Anëtarët e Bordit Drejtues që kanë dhënë dorëheqjen nga detyrat e tyre ose afatet ligjore të të cilëve kanë përfunduar nuk mund të emërohen si auditorë nëse nuk shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Auditorët e parë:

Atif Aysever, Zafer Mahallesi 44 Sokak Aysever Apt. Daire 7 Aydin, Nënshetas
Republikës Turke.

Detyrat dhe Pagat e Auditorëve Neni-17

Përveç kryerjes së detyrave të renditura në nenin 353 të Kodit Tregtar Turk, auditorët janë të autorizuar të ftojnë Asamblenë e Përgjithshme në mbledhje kur është e nevojshme, janë të autorizuar të vendosin agjendën e mbledhjes dhe të hartojnë raportin e shkruar në nenin 35 të ligjit.

Auditorët e kanë për detyrë dhe janë përgjegjës në vijimësi për moskryerjen në mënyrë të mirëfilltë të detyrave të tyre të shkruara në Kodin Tregtar Turk dhe në këtë marrëveshje.

Auditorët marrin pagë mujore ose vjetore në shumën e përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve.



Në rast të vdekjes së Auditorit, zbatohen dispozitat e nenit 351 të Kodit Tregtar Turk.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve

Neni-18

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve mbledhet si e Zakonshme dhe e Jashtëzakonshme. Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme mbledhet brenda 3(tre) muajve nga përfundimi i vitit financiar të kompanisë dhe të paktën një herë në vit.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve mund të thirret edhe në mbledhje të Jashtëzakonshme në çdo rast dhe kohë që e kërkojnë çështjet, punët e Shoqërisë sipas dispozitave të shkruara në Kodin Tregtar Turk dhe në këtë Statut. Merren vendime. (Merren parasysh edhe dispozitat e përcaktuara në nenin 369 të Kodit Tregtar Turk).

Vendi Ku Do Të Mbahet Mbledhja

Neni-19

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve do të mbahen në selinë e Shoqërisë ose në një vend të përshtatshëm që do të caktohet nga Këshilli Drejtues.

Prania E Një Përfaqësuesi të Ministrisë Në Takime

Neni-20

Ministria e Tregtisë do të njoftohet me shkrim të paktën 20 (njëzetë) ditë para për datën dhe vendin ku do të mbahen mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, qofshin këto të zakonshme apo të jashtëzakonshme. Bashkë me këtë njoftim Ministrisë do ti dërgohen edhe rendi i ditës dhe nga një kopje e dokumentacionit të nevojshëm.

Në këto mbledhje është e domosdoshme të jetë prezent edhe një komisar/përfaqësues nga Ministria. Nuk janë të vlefshme vendimet që merren në mbledhjet e Asamblesë së Aksionerëve që do të zhvillohen në mungesë të një përfaqësuesi të tillë.

Kuorumi i Mbledhjes

Neni-21

Në mënyrë që të merren vendime në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, është e domosdoshme të jenë të pranishëm në mbledhje Aksionarët që përfaqësojnë dy të tretat e kapitalit të Shoqërisë.

Në qoftë se ky kuorum nuk arrihet në mbledhjen e parë, atëherë Aksionarët thirren për të dytën herë në mbledhje.

Aksionarët që ndodhen prezentë në mbledhjen e dytë kanë të drejtë të hapin çështjet për diskutim dhe të marrin vendime pa marrë parasysh shumën e kapitalit që ata përfaqësojnë në mbledhje.

E drejta e votës

Neni-22

Në mbledhjet e Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme, Aksionarët ose të deleguarit e tyre prezentë në mbledhje kanë të drejtë të një vote për çdo aksion.



Mënyra e Votimit Neni-23

Në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, votat përdoren duke ngritur dorën lart.

Por me kërkesë të aksionarëve ose të deleguarëve të tyre që mbajnë të paktën një të dhjetën e kapitalit dhe që janë të pranishëm në mbledhje, vendoset që votimi të bëhet i mbyllur.

Përfaqësimi i Aksionarëve Neni-24

Në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, aksionarët mund të përfaqësohen nga një përfaqësues që do të emërojnë nga jashtë. Forma e fletë autorizimit të përfaqësuesit të aksionarëve përcaktohet dhe shpallet nga Bordi Drejtues.

Njoftimet/Shpalljet Neni-25

Njoftimet/shpalljet e Shoqërisë bëhen të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara përmes një gazete që botohet në vendndodhjen e selisë së Shoqërisë, me kusht që të rezervohen dispozitat e paragrafit 4 të nenit 37 të Kodit Tregtar Turk.

Njoftimet/shpalljet në lidhje me ftesën për mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhen të paktën dy javë më parë, duke përjashtuar njoftimin dhe ditët e mbledhjes në përputhje me dispozitat e nenit 368 të Kodit Tregtar Turk.

Për njoftimet në lidhje me likuidimin dhe zvogëlimin e kapitalit, zbatohet neni 397 i ligjit

Viti Financiar Neni-26

Zbatohen dispozitat e nenit 38 dhe

Viti financiar i Shoqërisë fillon ditën e parë të muajit janar dhe përfundon në ditën e fundit të muajit dhjetor. Vetëm se periudha e parë ushtruese e Shoqërisë fillon në datën e themelimit të saj dhe përfundon në fund të muajit dhjetor të atij viti.

Fitimi Neto Dhe Shpërndarja E Fitimit Neni-27

Pas zbritjes së shumave që kërkohen të lihen mënjanë ose të paguhen nga shoqëria, të tilla si shpenzimet e përgjithshme për vitin financiar dhe tarifat e ndryshme të amortizimit, nga të ardhurat e përcaktuara në fund të vitit financiar, shuma e mbetur përbën fitimin neto në fund të periudhës financiare (ushtrimit të mbyllur).

Fitimi neto i Shoqërisë i përcaktuar si më lart, ndahet dhe shpërndahet si më poshtë:

- 1) 5% e fitimit ndahet për rezervat e domosdoshme ligjore (deri sa të arrijë 20% të kapitalit të Shoqërisë).
- 2) 5% e fitimit shpërndahet si 1 dividend për shumën e mbledhur të vlerës së aksioneve të paamortizuara.
- 3) 3% e fitimit u shpërndahet anëtarëve të Bordit Drejtues.
- 4) 5% e fitimit për punonjësit si shpërblim i fundvitit brenda kuadrit të parimeve që përcaktohen nga Bordit Drejtues.



5) Pjesa e mbetur lihet mënjanë si fond për rinovimin e aseteve fikse të shoqërisë (Dispozita e nenit 466/3 të Kodit Tregtar Turk është e rezervuar)

Asnjë fitim nuk mund t'u shpërndahet aksionarëve, nëse rezervat ligjore dhe rezervat vullnetare dhe paratë që kërkohen të ndahen mënjanë në kuadër të dispozitave të ligjit dhe kontratës nuk ndahen nga fitimi neto.

Data e Shpërndarjes së Fitimit të Vitit Financiar Neni-28

Datat dhe mënyra në të cilën do të paguhen dividendët vjetorë ndaj aksionarëve vendosen nga Asambleja e Përgjithshme me propozimin e Bordit Drejtues.

Rezervat Neni-29

Kur rezerva ligjore e përcaktuar në paragrafin e parë të nenit 27 të kësaj kontrate arrin 20% të kapitalit të paguar të Shoqërisë, shuma e fondit rezervë që formohet duke përcaktuar përqindjen e tij nga Asambleja e Përgjithshme, përfundon.

Sidoqoftë, nëse kjo shumë zvogëlohet për shkak të shpenzimeve në raste të tilla mbulimi i humbjeve të periudhës së vitit financiar, mbajtja aktive e biznesit përballë luhatjeve konjunkturorë të tregut, rezervat vazhdojnë të kalohen përsëri derisa të arrijnë shumën e specifikuar në paragrafin e parë.

Shpërndarja Dhe Likuidimi I Shoqërisë Neni-30

Asambleja e Përgjithshme mund të thirret për mbledhje në çdo kohë për të diskutuar përfundimin ose likuidimin e shoqërisë ose zgjatjen ose shkurtimin e mandatit të saj sipas dispozitave të specifikuara në Kodin Tregtar Turk ose me vendimin e Bordit Drejtues.

Zyrtarët e likuidimit zgjidhen midis aksionarëve të kompanisë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

(Faqe 97)

Ndryshimet në Kontratë Neni-31

Plotësimi dhe zbatimi i çdo ndryshimi në këtë marrëveshje i nënshtrohet lejes së Ministrisë së Tregtisë. Ndryshimet në këtë drejtim janë të vlefshme me vërtetimin e duhur, regjistrimin në Regjistrin Tregtar dhe shpalljen e tyre.

Dokumentacioni që do të shkojë në Ministrinë e Tregtisë Neni-32

Tre kopje të raporteve të Bordit Drejtues dhe Bordit të Auditorëve, bilanceve vjetore dhe pasqyrës së llogaritjes së fitim/humbjes, procesverbaleve që janë mbajtur në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve dhe pasqyra me emrat e aksionarëve të cilët morën pjesë dhe numrin e aksioneve të zotërojnë ata duhet që brenda një muaji nga data e mbajtjes së mbledhjes të dërgohen në Ministrinë e Tregtisë ose ti dorëzohen Komisionarit të Qeverisë që ka qenë prezent në mbledhje.

Dispozita Ligjore Neni-33

Në lidhje me çështjet që nuk janë përshkruar në këtë Statut

ANKARA 10. NOTERLİĞİ
İMZA YETKİLİ KATİP
Osman ULUTAŞ

10

NÖ 09695

Ortakët Themelues:

Emër dhe Mbiemër, Nënshkrimi:

1. Mehmet Nuri Gocen: (nënshkrimi)

1 0 HAZIRAN 2021

Zbatohen dispozitat e Kodit Tregtar Turk.

2. Mustafa Gocen: (nënshkrimi)

3. Hamdi Gocen: (nënshkrimi)

4. Naile Gocen: (nënshkrimi)

5. Ibrahim Ethem Ozbay: (nënshkrimi)

DEKLARATE KORRIGJIMI

Ndryshimet në Statutin e Shoqërisë së GÖÇAY İnşaat Taahhüt ve Ticaret Anonim Şirketi, të cilat u konfirmuan nga miratimi i Noterit Nr.2 të Aydin-it i datës 2 Janar 1979 dhe numër rendor 77, të cilat u kërkuan me shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tregtisë së Brendshme të Ministrisë së Tregtisë datë 6/2 / 1979 dhe numër 3102, u bënë dhe u paraqitën si në shtojce me numrin rendor 5018 të datës 15 Shkurt 1979 nga Noteri Publik Nr.2 i Aydin-it.

Qëllimi I Operimit Dhe Objekti I Aktivitetit Të Shoqërisë Neni-3

Qëllimi i krijimit, operimit dhe objekti kryesor i shoqërisë është si më poshtë:

1) Shoqëria ndërton çdo lloj banese, fabrike, vend pune, depo, rrugë, diga, dekapazh, rezervuare, ujë i pijshëm, kanalizime, impiante ujitjeje, drenazhim, porte dhe fusha aviacioni, transport të llojeve të ndryshme dhe çdo lloj angazhimi me sipërmarrje; shitja dhe dhënia me qira e tregtimi i ndërtimeve të bëra, shërbime civile (Punime ndërtimi civile dhe industriale), projektim, komision, përfaqësim, të gjitha llojet e importit dhe eksportit, transport dhe punë kontraktimi të të gjitha llojeve brenda dhe jashtë vendit.

2) Merr pjesë në tenderët e nxjerrë nga institucionet zyrtare, personat fizikë dhe juridikë për punët që janë pjesë e objektit të aktivitetit të Shoqërisë, ose për punët/projektet që këto duan të realizojnë, ul dhe rrit ofertën e dorëzuar, jep/bën ofertë, bën/lidh kontratat.

3) Shoqëria merr në dorëzim me transferim nga persona të tjerë fizikë ose juridikë punë që janë pjesë e objektit të aktivitetit të saj ose ia transferon dikujt tjetër këto punë. Gjithashtu Shoqëria kryen punët e Komisionit Ndërmjetësues si dhe merr përsipër me tender dhe kontraktim punët e institucioneve të huaja zyrtare ose private.

4) Shoqëria krijon partneritet/ortakëri me personat fizikë dhe juridikë në lidhje me objektin e aktivitetit të saj, merr pjesë në ortakëritë e themeluara më parë. Për këtë qëllim Shoqëria blen certifikata aksionesh ose i transferon këto tek të tjerët; përfundon ortakërinë ose e likuidon atë.

5) Për të realizuar qëllimin dhe objektin e saj Shoqëria bën investimet e nevojshme, ndërton e hap fabrika dhe komplekse; nëse është e nevojshme blen importon, merr me qira makineri, pajisje dhe mjete motorike ose jo-motorike; blen pasuri të patundshme; në rast nevojë vendos kufizime, hipotekon në favor të personave të tretë patundshmeritë që janë në pronësi të saj, ose e heq hipotekimin duke e çliruar nga barrët; të vendosë

Nr: 140
nevojshme
raportin e sh
Auditor
mënyrë
marrë

të drejtat në natyrë në favor dhe disfavor të Shoqërisë; të kalojë në emrin e certifikatat/licensat e personave të tjerë fizikë dhe juridikë për punime kontraktuese.

6) Shoqëria blen ose shet të drejta koncesionare, licenca, të drejta të autorit, pronësisë intelektuale, të drejta industriale si know-how që janë të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të saj. Gjithashtu Shoqëria regjistron markat e veta ose transferon në emrin e vet marka të të tretëve.

7) Përveç punëve/aktiviteteve të përmendura më lart, në rast se në të ardhmen do të kërkohet angazhim për punë të tjera të vlefshme dhe të nevojshme për Shoqërinë, atëherë Shoqëria do të mund t'i kryejë edhe këto punë vetëm pas propozimit të Bordit Drejtues dhe miratimit nga Asambleja e Përgjithshme (e aksionarëve) dhe marrjes së vendimit në këtë drejtim.

Për zbatimin e këtij vendimi në cilësinë e ndryshimit të Statutit të Shoqërisë do të merren lejet e nevojshme nga Ministria e Tregtisë.

Mbledhja e Bordit Drejtues Neni-14

Bordi Drejtues mbledhet sa herë është e nevojshme nga biznesi dhe transaksionet e kompanisë. Sidoqoftë, me kusht që të rezervohen dispozitat e paragrafit 2 të nenit 330 të Kodit Tregtar Turk, ai mbledhet të paktën një herë në muaj në një kohë dhe vend për t'u përcaktuar nga vetë Bordi. Nëse nuk përcaktohet vendndodhja, vendi i takimit është selia e kompanisë.

Rendi i ditës i mbledhjes së zakonshme të Bordit Drejtues u njoftohet anëtarëve me letër rekomande të paktën 7 (shtatë) ditë para datës së mbledhjes nga Kryesia e Bordit Drejtues.

Auditorët Neni-16

Asambleja e Përgjithshme zgjedh midis aksionarëve të Shoqërisë ose jashtë saj 2 (dy) auditorë për një mandat (dy) 2-vjeçar.

Si auditorë të parë, për një periudhë njëvjeçare është zgjedhur jashtë aksionareve të shoqërisë janë zgjedhur:

- 1) Atif Aysever, Zafer Mahallesi 44 Sokak Aysever Apt. Daire 7 Aydin, Nënshetas i Republikës Turke.
- 2) Yusuf Ornekci, Sabunhane Gecidi A Blok Daire 4 Aydin, Nënshetas i Republikës Turke.

Auditori, mandati ligjor i të cilit ka përfunduar ose që nuk është shkarkuar nga detyra mund të rikthehet në këtë detyrë.

Kushdo që ka përfunduar mandatin e tij ose nuk është shkarkuar

Anëtarët e Bordit Drejtues që kanë dhënë dorëheqjen nga detyrat e tyre ose afatet ligjore të të cilëve kanë përfunduar nuk mund të emërohen si auditorë nëse nuk shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Detyrat dhe Pagat e Auditorëve Neni-17

Përveç kryerjes së detyrave të renditura në nenin 353 të Kodit Tregtar Turk, auditorët janë të autorizuar të ftojnë Asambleenë e Përgjithshme në mbledhje kur është



No 096

10 HAZIRAN 2021

Njoftime, janë të autorizuar të vendosin agjendën e mbledhjes dhe të ligjit.

Auditorët e kanë për detyrë dhe janë përgjegjës në vijimësi për moskryerjen në mënyrë të mirëfilltë të detyrave të tyre të shkruara në Kodin Tregtar Turk dhe në këtë marrëveshje.

Auditorët marrin pagë mujore ose vjetore në shumën e përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve.

Në rast të vdekjes së Auditorëve, zbatohen dispozitat e nenit 351 të Kodit Tregtar Turk.

Kuorumi i Mbledhjes

Në mënyrë që të merren vendime në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, është e domosdoshme të jenë të pranishëm në mbledhje Aksionarët që përfaqësojnë dy të tretat e kapitalit të Shoqërisë.

Neni-21

Në qoftë se ky kuorum nuk arrihet në mbledhjen e parë, atëherë Aksionarët thirren për të dytën herë në mbledhje.

Aksionarët që ndodhen prezentë në mbledhjen e dytë kanë të drejtë të hapin çështjet për diskutim dhe të marrin vendime pa marrë parasysh shumën e kapitalit që ata përfaqësojnë në mbledhje. Rezervohen dispozitat e nenit 388 të Kodit Tregtar Turk.

Njoftimet/Shpalljet

Neni-25

Njoftimet/shpalljet e Shoqërisë bëhen të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara përmes një gazete që botohet në vendndodhjen e selisë së Shoqërisë, me kusht që të rezervohen dispozitat e paragrafit 4 të nenit 37 të Kodit Tregtar Turk.

Njoftimet/shpalljet në lidhje me ftesën për mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhen të paktën dy javë më parë, duke përjashtuar njoftimin dhe ditët e mbledhjes në përputhje me dispozitat e nenit 368 të Kodit Tregtar Turk.

Për njoftimet në lidhje me likuidimin dhe zvogëlimin e kapitalit, zbatohet neni 39 dhe 438 i Kodit.

Fitimi Neto Dhe Shpërndarja E Fitimit

Neni-27

Pas zbritjes së shumave që kërkohen të lihen mënjane ose të paguhen nga shoqëria, të tilla si shpenzimet e përgjithshme për vitin financiar dhe tarifat e ndryshme të amortizimit, nga të ardhurat e përcaktuara në fund të vitit financiar, shuma e mbetur përbën fitimin neto në fund të periudhës financiare (ushtrimit të mbyllur).

Fitimi neto i Shoqërisë i përcaktuar si më lart, ndahet dhe shpërndahet si më poshtë:

- 1) 5% e fitimit ndahet për rezervat e domosdoshme ligjore (deri sa të arrijë 20% të kapitalit të Shoqërisë).
- 2) 5% e fitimit shpërndahet si 1 dividend për shumën e mbledhur të vlerës së aksioneve të paamortizuara.
- 3) 3% e fitimit të mbetur u shpërndahet anëtarëve të Bordit Drejtues.
- 4) 5% e fitimit të mbetur për punonjësit si shpërblyerje fundviti brenda kuadrit të parimeve që përcaktohen nga Bordit Drejtues.

- 5) Pjesa e mbetur lihet mënjanë si fond për rinovimin e aseteve fikse të shoqërisë.
(Dispozita e nenit 466/3 të Kodit Tregtar Turk është e rezervuar)

Asnjë fitim nuk mund t'u shpërndahet aksionarëve, nëse rezervat ligjore dhe rezervat vullnetare dhe paratë që kërkohen të ndahen mënjanë në kuadër e dispozitave të ligjit dhe kontratës nuk ndahen nga fitimi neto.

ORTAKËT THEMELUES:

Emër dhe Mbiemër, Nënshkrimi:

- | |
|--------------------------------------|
| 1. Mehmet Nuri Gocen: (nënshkrimi) |
| 2. Mustafa Gocen: (nënshkrimi) |
| 3. Hamdi Gocen: (nënshkrimi) |
| 4. Naile Gocen: (nënshkrimi) |
| 5. Ibrahim Ethem Ozbay: (nënshkrimi) |

(Faqe 98)

Baza ligjore

Mustafa Gocen i autorizuar me të drejtën për nënshkrim deklaratash, krijim kompanie dhe të ngjashme në emër të personave të përfaqësuar, me autorizimin e Naile Gocen të datës 7/6/1978 dhe me numër 21386 të Noterit të Tetë të Beyoglu-së dhe autorizim të Hamdi Gocen të datës 28 / 12/1978 dhe me numër 32955 të Noterit të Dytë të Ajdin-it dhe të numëruar 32955.

Noteri i 2-të i Aydin-it
Suleyman Cincinoglu
(Vulë zyrtare dhe nënshkrim)

Pasi deklarata e korrigjimit të neneve 3, 14, 16, 17, 21,25 dhe 27 e Statutit me 33 nene gjithsej të shoqërisë GÖÇAY İnşaat Taahhüt ve Ticaret Anonim Şirketi konsiderohet e përshtatshme, u lejua krijimi i kësaj Shoqërie në përputhje me dispozitat e nenit 273 të Kodit Tregtar Turk.

*İşbu belge ...Türkçe... aslından
Anonim Şirkete'ye tarafımdan çevrilmiş
olduğunu beyan ederim.
Noter Yeminli Mütercim:
Serdar...Hüseyin...*

Në emër të
Ministrit të Tregtisë
Semsettin Vural
Kryendihmës i Drejtorit të
Përgjithshëm të Tregtisë
së Brendshme

*İşbu belgenin dairemizde kimliği saklı
yeminli tercümanımız Serdar...Hüseyin...
tarafından ...den Anonim Şirkete'ye
çevrilmiş olduğunu onayladım.*

APOSTILLE
(Convention de La Haye du 5 Octobre 1961)

1. Ülke/Country/Pays/Staat TÜRKİYE - LA TURQUIE

İşbu resmi belge/This public document/Le présent acte public/Dieses zeugnis wurde

2. Osman ULUTAŞ tarafından imzalanmıştır./Has been signed by/a été signé par/durch ...
unterschrieben

3. İmzalayanın sıfatı Yetkili Katip'dir./Acting in the capacity of/Agissant en qualité de/Titel des
Unterzeichneten

4. ANKARA 10 NOTERLİĞİ 'nin mühür/damgasını taşımaktadır-bears the seal/stamp of-/est
revéu du sceau/timbre de-trägt Siegel/Stempel von

TASDİK / CERTIFIED / ATTESTE / BEGLAUBIGUNG:

5. Mamak Kaymakamlığı' da/at/à/in


6. 11.06.2021 günü/the/le/Am

7. V.H.K.İ Fatih ÖZTÜRK tarafından/by/par/durch den/die

8. No : 13623 ile tasdik edilmiştir./No:/sous No:/unter Nr.

9. Mühür - Damga/Seal-stamp/Sceau-
timbre/Siegel-Stempel

10. İmza/Signature/Signature/Unterschrift:



.....



DÜZELTME BEYANNAMESİ

Aydın 2. Noterliğinin 2 Ocak 1979 tarih ve 76 yevmiye numaralı onayı ile onaylanmış Bakırçı Toprak Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi Anasözleşmesine, Ticaret Bakanlığı İç Ticaret Genel Müdürlüğü'nün 17/1/1979 tarih ve 1175 sayılı yazıları ile istenen değişiklikler, Aydın 2. Noterliğinin 22 Ocak 1979 tarih ve 2046 yevmiye numarası ile yapılmış ve ilişikte sunulduğu şekilde onaylanmıştır.

Madde 14 —

YÖNETİM KURULUNUN TOPLANMASI :

Yönetim Kurulu şirket işleri ve muameleleri gerekli kıldıkça toplanır. Ancak, Türk Ticaret Kanununun 330. maddesinin 2. fıkrası hükümleri saklı kalmak şartıyla en az ayda bir kendi belirleyeceği zaman ve yerde toplanır. Yer belirtilmediği takdirde, toplantı yeri, şirketin merkezidir.

Yönetim Kurulu olağan toplantısının gündemi, Yönetim Kurulu Başkanlığı'na toplantı gününden en az 7 (yed) gün önce taahhütlü mektupla üyelere bildirilir.

DENETÇİLERİN GÖREVLERİ VE ÜCRETLERİ :

Madde 17 —

Denetçiler, Türk Ticaret Kanununun 353. maddesinde sayılan ödevleri yapmakta başka, gerektiği hallerde Genel Kurul'u toplantıya davete, toplantı gündemini tayine, Kanununun 354. maddesinde yazılı raporu tanzime selâhiyettardır.

Denetçiler, Türk Ticaret Kanununun ve işbu sözleşme ile kendilerine verilen görevleri iyi yapmaktan dolayı müteselsilen sorumlu olurlar.

Denetçiler, Genel Kurul'ca tayin ve tesbit edilen miktarda aylık veya yıllık ücret alırlar.

Denetçinin ölümü halinde, Türk Ticaret Kanununun 351. maddesi hükümleri uygulanır.

TOPLANTI YERİ :

Madde 19 —

Genel Kurul toplantıları, şirketin merkezinde veya merkezinin bulunduğu şehrin elverişli bir yerinde yapılır.

İLANLAR :

Madde 25 —

Şirkete ait ilanlar, Türk Ticaret Kanununun 37. maddesinin 4. fıkrası hükümleri saklı kalmak şartıyla, şirket merkezinin bulunduğu yerde yayınlanmakta olan bir gazete aracılığı ile asgari 15 (onbeş) gün önce yapılır.

Genel Kurul'u toplantıya davetine ait ilanlar, Türk Ticaret Kanununun 368. maddesi hükümleri mucibince ilan ve toplantı günleri hariç olmak üzere en az iki hafta önce yapılması gerekir.

Tasfiye ve sermayenin azaltılmasına ait ilanlar için Kanunun 397 ve 438. maddeleri hükümleri tatbik edilir.

SAFİ KÂR VE KÂRIN DAĞITILMASI :

Madde 27 —

Hesap yılı sonunda tesbit edilen gelirlerden, dönem genel giderleri ile muhtelif amortisman bedelleri gibi şirketçe ayrılması veya ödenmesi gerekli olan tutarlar düşüldükten sonra kalan tutar dönem safi kârını meydana getirir.

Yukarıdaki şekilde tesbit edilen Şirketin dönem safi kârı aşağıda yazılı şekilde ayrılır ve dağıtılır :

1) Kârın % 5 i kanunî yedek akçeye (şirket esas sermayesinin % 20 sine varıncaya kadar.)

2) Kârın % 5 i itfa edilmemiş pay bedellerinin, tahsil edilmiş miktarına 1. temettü olarak dağıtılır.

3) Kalan kârın % 3 ü Yönetim Kurulu üyelerine,

4) Kalan kârın % 5 i Yönetim Kurulu'nun tesbit edeceği esaslar çerçevesinde yıl sonu ikramiyesi olarak işgörenlere,

5) Geri kalan şirket sabit kıymetlerinin yenilenme fonu olarak ayrılır. (Türk Ticaret Kanununun 466/3 hükmü mahfuzdur.)

Kanunî ve ihtiyari yedek akçeler ile kanun ve sözleşme hükümleri ışığında ayrılması zorunlu paralar safi kârdan ayrılmadıkça pay sahiplerine kâr dağıtılamaz.

Kurucular :

Adı soyadı ve imzası :

1) Mehmet Nuri Göçen : (İmza),

2) Mustafa Göçen : (İmza),

3) Hamdi Göçen : (İmza),

4) Naile Göçen : (İmza),

5) İbrahim Ethem Özbay : (İmza)

İşbu düzeltme

MÜSTENİDAT :

1 — Beyoğlu Sekizinci Noterliğinin 7/6/1978 gün ve 21386 No.lu vekâletnamesiyle Naile Göçen'e

TRANSLATION SERVICES since 1996
MED KASIS LTD STA. Ankara D. 613 053 6467

Yol: Gökçe 2/100 Kızılay Ankara

Telefon: 312 418 88 21 Faks: +90 312 418 75 69

Mobil: +90 554 402 36 44

E-mail: Info@ayguntercume.com.tr • ayguntercume@yahoo.com

2 — Aydın İkinci Noterliğinin 28/12/1978 gün ve 32955 sayılı ve kâletnamesine göre Hamdi Göçen'e vekâleten ve mukavele imzasını beyannameler takdimine Mustafa Göçen selâhiyettir.

10 HAZİRAN 2021

Aydın İkinci Noterliği
Süleyman Cincinoğlu
(Resmî mühür ve imza)

Bakırçı Toprak Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketinin 33 asıl maddeden ibaret olan Anasözleşmesi ve 14, 17, 19, 25, 27 nci maddelere ait düzeltme beyannamesi uygun görüldüğünden; bu şirketin Türk Ticaret Kanununun 273 ncu maddesi gereğince kurulmasına izin verilmiştir.

Ticaret Bakanı a.
Şemsettin Vural
İç Ticaret Genel Müdür
Eaş Yardımcısı
(Resmî mühür ve imza)
09/346

Aydın Ticaret Sicilli Memurluğundan :

Sicil No : 4294

GOÇAY İNŞAAT, TAAHHÜT VE TİCARET ANONİM ŞİRKETİ
TİCARET UNVANI :

Muamelât Merkezi Aydın İli Cuma Mahallesi Gazi Bulvarı 12 No. da olup Statünün 3 ncu maddesinde yazılı iş konuları ile istigal etmek üzere Aydın Asliye Birinci Hukuk Mahkemesinin Esas 979/71 D. İş - Karar 979/73 D. İş sayılı ilâmı ile 33 asıl maddeden ibaret olan Anasözleşmenin 3/14/168

Anasözleşmenin 3, 14, 16, 17, 21, 25, 27 maddelerine ait düzeltme beyanı Ticaret Bakanlığınca uygun görüldüğünden Türk Ticaret Kanununun 273 ncu maddesi gereğince 2/3/1979 tarihli onayı ile kurulmasına izin verilen Anonim Şirket Statüsü Türk Ticaret Kanunu hükümlerine uygun olarak 13/3/1979 tarihinde tescil edildiği ilan olunur.

Asliye Birinci Hukuk Mahkemesi :

Esas No : 979/71 D. İş

Karar No : 979/73 D. İş

TİCARET MAHKEMESİ SIFATIYLA

K A R A R

H. Hakim : I. Remzi Köse 13797

Kâtip : Hatice Baysal

Davacılar : Kuruluş halinde GOÇAY İnşaat Taahhüt ve Ticaret Anonim Şirketi Ortakları.

1 — Mehmet Nuri Göçen, Gazi Bulvarı No: 12 Aydın.

2 — Mustafa Göçen, Büyük Menderes Bulvarı No: 20/8 Aydın.

3 — Hamdi Göçen : Zafer Mahallesi 42 Sokak No: 5 Aydın.

4 — Naile Göçen, Zafer Mahallesi 42 Sokak No: 5 Aydın.

5 — İbrahim Ethem Özbay, Zafer Mahallesi 42 Sokak No: 8 Aydın.

Dava : GOÇAY İnşaat Taahhüt ve Ticaret Anonim Şirketi'nin kuruluşunun tasdiki talebi.

Davacı şirket adına yönetim kurulu tarafından mahkememize verilen 8/3/1979 tarihli dilekçede 600.000,— lira sermaye ile kurulacak olan GOÇAY İnşaat Taahhüt ve Ticaret Anonim Şirketi'ne ait sözleşmenin Ticaret Bakanlığının 2/3/1979 tarih ve 10471 sayılı belge ile izin verilmiş olduğu Ticaret Kanunu hükümlerinin yerine getirildiğini bildiren Anonim Şirketin tasdikine karar verilmesini istemişlerdir.

Evrak üzerinde yapılan tetkikat sonunda :

GEREĞİ DÜŞÜNÜLDÜ :

Türk Ticaret Kanununun, aynı kuruluş hükümlerine göre ticari merkezi Aydın olmak üzere 600.000 Lira sermaye ile kurulmak istenen GOÇAY İnşaat Taahhüt ve Ticaret Anonim Şirketi sermayesinin % 25 olan 150.000 Lira Pamukbank Türk Anonim Şirketi Aydın Şubesine 2/1/1979 tarihinde yatırılmış olduğu ve Ticaret Bakanlığı İç Ticaret Genel Müdürlüğü'nün 2/3/1979 tarih ve 10471 sayılı yazılarına göre Anonim Şirketin Türk Ticaret Kanununun 273 ve müteakip maddelerine göre uygun görülerek müsaade edilmiş, olmakla esas sermayenin % 25 de ödendiği anlaşıldığından ve usulî muameleler ikmal edilmiş olduğu görüldüğünden GOÇAY İnşaat Taahhüt ve Ticaret Anonim Şirketi'nin kuruluşunun tasdikine, 100 lira tasdik harcının davacıardan alınmasına evrak üzerinde tetkikat yapılarak karar verildi. 8/3/1979

Kâtip : (İmza),

Hakim : 13727 (İmza).

Aydın İkinci Noterliğinin 28/12/1978 tarihli ve 32955 sayılı GOÇAY İnşaat Taahhüt ve Ticaret A.Ş. vekâletnamesine göre yukarıda tarifinde alınan 8/3/1979 tarihli ve 10471 kararına göre yukarıda tarifli yazılı şirketin bildirim raporu, davacılar, özel tüzel kişiler, bankalar, hakiki ve hukukî şahısların tasdik ve taahhüt altına girmeğe, ihalelere istisna etmeğe, müdahale etmeğe, pay girmeye, teminat yatırma ve tahvil etmeğe, mukavelelerini

ANKARA 10. NOTERLİĞİ

İMZA YETKİLİ KATİP

Osman ULUTAS

